



Koment

Per Regjistrin Qendror te Llogarive Bankare

Ne Fletoren zyrtare 5/2021 eshte botuar ligji 154/2020 date 17.12.2020 “Per Regjistrin Qendror te Llogarive Bankare” ku:

Ne nenin 5, Regjistri Qendror i Llogarive Bankare, pika 1 theksohet

1. Regjistri krijohet si një bazë të dhënash shtetërore, ku grumbullohet në formë të organizuar informacioni i ruajtur në formë elektronike për çdo mbajtës të llogarive bankare dhe të kasetave të sigurisë, në të cilin regjistrohen të dhënat e raportuara nga institucionet financiare.

Ndersa ne nenin 6, Krijimi dhe administrimi i regjistrit, pika 1 theksohet

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është institucioni administrues i regjistrit.

Ky ligj hyn ne fuqi ne fund te janarit 2021

Nderkohe:

Me ligjin 31/2019 date 17.06.2019, ndryshim ne ligjin e Procedurave,(pika 1/2 dhe 1/3 te nenit 59) kerkohet:

“1/2. Tatimpaguesit persona fizikë tregtarë, të regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar, tatimpaguesit persona juridikë, pavarësisht nga qarkullimi që realizojnë, si dhe organizatat jofitimprurëse të regjistruara në organin tatimor, **janë të detyruar të kenë llogari bankare të biznesit/organizatës së regjistruar dhe ta deklarojnë atë në administratën tatimore.**

1/3. Tatimpaguesit e regjistruar rishtas, **janë të detyruar të hapin llogarinë bankare të biznesit/organizatës jo më vonë se 20 ditë kalendarike nga e nesërmyja e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit/administratën tatimore dhe ta deklarojnë atë në administratën tatimore.**”.

Komenti im:

Pas kesaj, duke qene se Administrata tatimore do ti marre te dhenat bankare ne menyre elektronike nga sistemi bankar

A ka kuptim qe tatimpaguesit te raportojne ne administraten tatimore per llogarite bankare te biznesit, (shto ketu dhe çdo ndryshim mbyllje dhe hapje llogarie te re ne te gjitha bankat) ?

A perben shqetesim te panevojeshem per tatimpaguesin?

A duhet abroguar ligji i me siperm?

Per gjithçka parashtrova me siper, **mendimin ndryshe e mirepres** me rrespekt.

Vleresimi eshte i gjithsejçilit.

Luan GOSNISHTI

Auditues Ligjor

Durres 15.01.2021